



## **Projekti SPI Albania: Përmirësimi I procedurave të ankandit për ekzekutimin e kolateralit**

### **Komente mbi përmbajtjen e projektligjit “Për liberalizimin e shërbimit të përmbartimit gjyqësor”**

#### **I. Komente të përgjithshme.**

- Ne Relacionin Shpjegues thuhet se për traditën dhe kushtet e vendit tone është menduar që Shërbimi Përmbartimor të jetë i sistemit të dyfishtë (two track system). *Pikërisht bazuar në traditën e vendit tone, kur dihet që ka vështirësi në edukimin e qytetareve dhe funksionareve për të respektuar ligjin, mund të jete e parakohshme që një Shërbim Ekzekutimi vendimesh i llojit privat, të ketë efektivitet në praktike.*
- Kalimi në një shërbim privat, do të sjelle automatikisht rritje të kostos së procesit, që paraprakisht duhet të paguhet nga kreditorët. Kjo do të sillte rritje të kostos së kredidhënies dhe për pasoje do të ndikonte në rritjen e interesave apo komisioneve që bankat do aplikojnë për kredidhënien.

*Natyrshëm na lind pyetja, A e përballon tregu shqiptar një rritje të tillë të kostos së kredidhënies?*

- Vete Relacioni identifikon si të mundshëm fenomenin që Shërbimi i Përmbartimit Privat të mos preferojë të zgjerohet në zonat rurale. Kjo ka shumë probabilitet të ndodhë, pra ky liberalizim do t’ju shërbejë një numri të vogël dhe të kufizuar njerëzish.

*Çfarë do të ndodhë me dosjet e bankave kur kolaterale të jenë si në qytet edhe në fshat (i njëjti debitor).*

- Në Relacion shpjegohet se detyra që përmbartuesi privat do të ushtroje do të konsiderohet si një “ funksion publik i deleguar”. *Nga vete rëndësia e këtij shërbimi, nga mungesa e një edukate respektuese të ligjit në ato nivele që të ndërjegjësojë minimalisht popullatën për zbatimin e vendimeve, ky funksion “detyrues” i pushtetit shtetëror mendojmë se edhe për disa kohe duhet të vazhdojë të mbetet pjesë e sistemit publik. Mbase duhet gjetur mënyra të mbështetjet dhe riorganizohet sektori shtetëror.*

#### **SPI Albania Secretariat**

Mrs. Anuela Ristani, Director of Operations, [anuela.ristani@spi-albania.eu](mailto:anuela.ristani@spi-albania.eu)

Ms. Elona Bollano, Director of Analytics and Policy, [elona.bollano@spi-albania.eu](mailto:elona.bollano@spi-albania.eu)

Address: Twin Tower I, Kati 6, Apt. A3. Tirana, Albania. Tel. +355 42 280 359; Fax. + 355 42 280 371

- E drejta për te ushtruar veprimtari si përmbarues privat edhe nga persona fizike, *ne duket e pavend. Ky shërbim kërkon shume logjistike, mbështetje te organizuar nga policia, qofte edhe private, etj. Nuk mund te behet paralelizma me shërbimin noterial, pasi noteri ka një veprimtari shume komode dhe te parriskuar nga kundërshtimi i palës ndaj te cilës do aplikohet ekzekutimi. Mendojmë se me mire do ishte që të bëhej e detyrueshme ne ligj qe te jene vetëm persona juridik, siç u be ne rastin e Shoqërive te Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike (e ashtuquajtura polici private), pasi kemi te bëjmë me po te njëjtin lloj funksioni publik: përdorimi i forcës shtrënguese te shtetit për respektimin e ligjit/ detyrimeve.*
- Ka një konfuzion ne konceptin e Personit Juridik qe ushtron veprimtari përmbaruese private. Duhet ripare dhe te futet pozita e drejtuesit profesional (teknik) te këtij subjekti.
- Mënyra si e parashikon drafti problemin e marrëdhënieve financiare: pale kreditore / përmbarues privat, duhet rishqyrtuar. Ideja e pagesave shtese, pa një kriter baze, ideja e moskthimit te shumës se parapaguar kur përmbaruesi privat ja kthen dosjen kreditorit pa përfitim financiar, rastet e moskthimit te parapagimeve kur debitori bën pagesa vullnetare, sidomos pa kaluar ne fazën e ankandit, *janë fare te papranueshme për një marrëdhënie korrekte te palëve dhe le shume vend për abuzim.*

## **II. Komente specifike për nenet e projekt ligjit**

1. Në bazën ligjore, sugjerojmë që të hiqet neni 81, pika 2, shkronja “a” e Kushtetutës, sepse mendojmë se kjo dispozitë kushtetuese vendoset në ato projektligje që parashikojnë organizimin dhe funksionimin e institucioneve kushtetuese, ndërkohë që Përmbarimi Gjyqësor nuk është institucion kushtetues.
2. Nga përmbajtja e pikave 4 dhe 5 të relacionit shoqërues kuptojmë se është menduar të ketë një ndarje të titujve ekzekutiv që do jenë në kompetencë të Përmbarimit Gjyqësor Privat (PGJP) dhe të Përmbarimit Gjyqësor Shtetëror (PGJSH), por vërejmë se në përmbajtjen e projektligjit nuk ka parashikim specifik në lidhje me kategoritë e titujve ekzekutiv të përcaktuara në nenin 510 (të ndryshuar) të KPC. ër sa më sipër, sugjerojmë që të shtohet një paragraf i veçantë në nenin 3, në mënyrë që të evitohen përplasje të ndryshme ndërmjet subjekteve përmbaruese private dhe atyre shtetërore.
3. Konstatojmë se projektligji i dërguar për mendim titullohet “Për liberalizimin e shërbimit të përmbarimit gjyqësor”. Kuptojmë se liberalizimi i shërbimit përmbarimor konsiston në qëllimet dhe objektivat që synohen të realizohen nëpërmjet miratimit të këtij projektligji, ndërkohë që objekti i mirëfilltë i rregullimit juridik të këtij projektligji është përcaktimi i parimeve dhe rregullave për organizimin e shërbimit përmbarimor privat. Bazuar në argumentat e lartpërmendura jemi të mendimit se do të ishte më e përshtatshme që titulli i këtij projektligji të reflektonte përmbajtjen sesa qëllimet që synohen të realizohen nëpërmjet miratimit të tij, ndaj për këtë arsye sugjerojmë që ky

projektligj të rititullohet “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarrimor Privat”.

4. Konstatohet se fjalia e parë e nenit 3 të projektligjit, të titulluar “Fusha e zbatimit”, përcakton shprehimisht se:

*Cit: “Ky ligj zbatohet për subjektet fizike e juridike private apo shtetërore, që kanë si objekt të veprimtarisë së tyre ekzekutimin e titujve ekzekutivë...”*

Jemi të mendimit se fusha e zbatimit të një ligji duhet të përcaktojë tërësinë e marrëdhënieve juridike që rregullohen prej tij dhe jo rrethin e subjekteve që mund t'i nënshtrohen zbatimit të tij. Për këtë arsye sugjerojmë që fjalia e parë e nenit 3 të projektligjit, të titulluar “Fusha e zbatimit”, të riformulohet si vijon:

*Cit: “Ky ligj zbatohet për ekzekutimin e detyrueshëm nëpërmjet Shërbimit Përmbarrimor Privat të titujve ekzekutivë, në rastet e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile”.*

5. Konstatohet se organet shtetërore që merren me ekzekutimin kanë një ligj tjetër organik.
6. Nëse do kemi dy sisteme (shtetëror dhe privat) që do punojnë paralelisht, nuk ka arsye që të preferojmë edhe me dispozite ligjore shërbimin privat. Mendojmë se nuk ka sens llogjik dhe duhet të respektohet kompetenca territoriale ashtu sic e ka aktualisht K.Pr.Civile.
7. Tek pika “a” e nenit 6 “Subjektet që ushtrojnë Shërbimin Përmbarrimor Privat”. A do mundet kjo kategori ta përmbushë detyrën, kur duhet shume bashkërendim, mjete logjistike, force shtrënguese. Në këtë kontekst ndoshta me mire do të ishte të përdoret shembulli i SHRSF-ve.
8. Konstatohet se në këtë neni përcaktohet se subjektet që mund të ushtrojnë funksionin e shërbimit përmbarrimor privat mund të jenë si personat fizikë ashtu dhe personat juridikë tregtarë. Ndërkohë neni 12 i projektligjit përcakton se asnjë përmbarrues privat nuk mund të ushtrojë veprimtarinë pa qenë i pajisur me licencën përkatëse nga Ministri i Drejtësisë. Për sa i përket kërkesave që kanë lidhje me licencimin e përmbarruesve privatë jemi të mendimit se projektligji duhet të përcaktojë qartë nëse në rastin e personave juridikë tregtarë licenca i jepet me titull individual përmbarruesve privatë që mund të jenë të punësuar apo themelues të personit juridik tregtar, apo i jepet vetë personit juridik tregtar. Mendojmë se përcaktimi i saktë i kësaj çështjeje i shërben qartësisë të përgjegjësisë civile dhe penale që projektligji parashikon për përmbarruesit privatë, në rastin kur këta të fundit janë të organizuar në formën e një personi juridik tregtar.
9. Në shkronjën “e” të pikës 10 të projektligjit, të titulluar “Përgjegjësitë e Ministrit të Drejtësisë”, si dhe në Kreun IX të tij të titulluar “Procedimi disiplinor”, parashikohet si e drejta e Ministrit të Drejtësisë për të filluar procedurën disiplinore ndaj një përmbarruesi privat ashtu dhe kompetenca e Ministrit të Drejtësisë për të marrë vendimin përfundimtar për refuzimin ose caktimin e masës disiplinore. Jemi të mendimit se parashikimi i projektligjit sipas të cilit Ministri i Drejtësisë është i njëjti organ i cili njëkohësisht propozon dhe cakton masën disiplinore ndaj përmbarruesve

privatë, përbën papajtueshmëri dhe nuk jep garanci për zhvillimin e paanshëm dhe objektiv të procedurës disiplinore.

10. Konstatohet se në nenin 7 të projektligjit funksioni i Shërbimit Përbarimor Privat përcaktohet si ushtrimi i një funksioni me karakter publik, ndërkohë që në nenin 11 të projektligjit jepen rastet e konfliktit të interesit në ushtrimin e këtij funksioni. Jemi të mendimit se meqenëse projektligji parashikon se funksioni i Shërbimit Përbarimor Privat konsiston në ushtrimin e një përgjegjësie me karakter publik, gjendet e konfliktit të interesave në ushtrimin e detyrës së përbaruesit privat duhet të trajtohen edhe sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, veçanërisht nenit 5 të tij. Për këtë arsye sugjerojmë që në nenin 11 të projektligjit, të titulluar “Konflikti i interesit”, pas shkronjës “g” të shtohet shkronja “h” me përmbajtjen e mëposhtme:

*Cit: “Në rastet kur vërtetohet ekzistenca e rrethanave të interesave private sipas përcaktimeve të nenit 5 të Ligjit Nr.9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.*

11. Në nenin nr 8, **Statusi ligjor i përbaruesit privat, (si neni 6)** A do mundet kjo kategori ta përmbushë detyrën, kur duhet shume bashkërendim, mjete logjistike, force shtrënguese. Ndoshta me mire do të ishte të përdoret shembulli i SHRSF-ve.
12. Konstatohet se në nenin 6 përcaktohet se subjektet që mund të ushtrojnë funksionin e shërbimit përbarimor privat mund të jenë si personat fizikë ashtu dhe personat juridikë tregtarë. Ndërkohë neni 12 i projektligjit përcakton se asnjë përbarues privat nuk mund të ushtrojë veprimtarinë pa qenë i pajisur me licencën përkatëse nga Ministri i Drejtësisë. Për sa i përket kërkesave që kanë lidhje me licencimin e përbaruesve privatë jemi të mendimit se projektligji duhet të përcaktojë qartë nëse në rastin e personave juridikë tregtarë licenca i jepet me titull individual përbaruesve privatë që mund të jenë të punësuar apo themelues të personit juridik tregtar, apo i jepet vetë personit juridik tregtar. Mendojmë se përcaktimi i saktë i kësaj çështjeje i shërben qartësisë të përgjegjësisë civile dhe penale që projektligji parashikon për përbaruesit privatë, në rastin kur këta të fundit janë të organizuar në formën e një personi juridik tregtar.
13. Në neni 9, cili autoritet do ta vendosë këtë papajtueshmëri? Në këtë mënyrë vlerësojmë se mund të lihet vend abuzimeve, subjektivizmave dhe mohimit të drejtës për licensim. Rastet e kufizimit ligjor duhet të jene të qarta, ne të kundert bien ndesh me të drejtat e individit për të përfituar nga mundësitë që i jep ligji.
14. Konstatohet se në nenin 6 të projektligjit përcaktohet se subjektet që mund të ushtrojnë funksionin e shërbimit përbarimor privat mund të jenë si personat fizikë ashtu dhe personat juridikë tregtarë. Ndërkohë neni 12 i projektligjit përcakton se asnjë përbarues privat nuk mund të ushtrojë veprimtarinë pa qenë i pajisur me licencën përkatëse nga Ministri i Drejtësisë. Për sa i përket kërkesave që kanë lidhje me licencimin e përbaruesve privatë jemi të mendimit se projektligji duhet të përcaktojë qartë nëse në rastin e personave juridikë tregtarë licenca i jepet me titull individual përbaruesve privatë që mund të jenë të punësuar apo themelues të personit juridik tregtar, apo i jepet vetë personit juridik tregtar. Mendojmë se përcaktimi i saktë i kësaj çështjeje i shërben qartësisë të përgjegjësisë civile dhe

penale që projektligji parashikon për përmbauesit privatë, në rastin kur këta të fundit janë të organizuar në formën e një personi juridik tregtar.

15. Te pika “g” e nenit nr 10, duhet specifikuar se cilit Keshill te Pergjithshem.
16. Nga pikpamja e tenknikes legjislative, ndoshta do te ishte me mire qe neni 11 te vije pas atij te Papajtueshemrise.
17. Tek pika “b” e nenit 11 , te shtohet “apo perfaqesuesi” pas fjales “kujdestari”.
18. Tek pika “b” e nenit 11, Edhe kur eshte person fizik mund te jete ortak ne nje shoqeri, prandaj me mire te hiqet dhe thuhet direk “eshte ortak “ pa bere specifikime.
19. Tek neni 13, mendojme se duhet te hiqet si opsion personat fizike dhe nëse do jete person juridik duhen shtuar patjeter kushtet qe duhet te plotesoje Personi Juridik sipas ligjit “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”
20. Per piken “e” te nenit 13, Po ai qe punon jurist ne nje subjekt privat nuk mund te perfitoje? Po ai qe punon oficer gjyqsor? Etj, raste ku mund te punoje ne profesion nje jurist i diplomuar dhe mendoj se 7 vjet Eshte shume si afat Ose te plotësohet vetëm njëra prej dy pikave (pika d ose pika e) Tek pika “g”e nenit 13 Per Personat juridik eshte e detyrueshme edhe drejtimi profesional (si ne rastin e drejtuesit teknik tek shoqerite ndertuese)
21. Te neni 17, Forma e kerkeses per regjistrim, duhen shtuar dokumentet e drejtuesve teknik – qe profesionalisht do drejtojen kete subjekt.
22. Në nenin 18 të projektligjit parashikohet krijimi i regjistrit të përmbauesve privatë të licencuar pranë Ministrisë së Drejtësisë. Sugjerojmë që për efekt të transparencës dhe lehtësisë të aksesimit të shërbimit përmbauesve privat nga subjektet e interesuara, ky regjistër duhet të jetë i publikueshëm dhe të mund të konsultohet nga publiku. Për këtë arsye sugjerojmë që në nenin 18 të projektligjit, të titulluar “Regjistri i përmbauesve privatë”, të shtohet një fjali me përmbajtjen e mëposhtëme:  
  
*Cit:” Regjistri i përmbauesve privatë është i publikueshëm dhe mund të konsultohet nga publiku”.*
23. Mendoj se te neni 21, akreditimi i personave juridike, Shoqëri Tregtare mund ta krijoje edhe nje subjekt jo profesional, por drejtimin duhet ta beje nje i licensuar. Shembulli i shoqerive te ndertimit.
24. Per permbauesit private, hapja e llogarise mendoj se nuk duhet shprehur si e drejte, por si detyrim. Aktualisht Qeveria po perpiqet qe t’ i jape fund informaliteit dhe ky paragraf bie ndesh me kete strategji qe synon te na ofroje me Europern edhe ne legjislacion. (neni 23)
25. Neni 24 nuk eshte e qarte A do kete ai ndonje sanksion, sepse mund te ndodhe qe ne ujdj me palen debitore ta mbaje gjoja ne proces dosjen dhe ta ktheje pa rezultat, duke demtuar interesin e pales kreditore per shkak kalim afatesh .....

26. Ne piken “b” te nenit Çregjistrimi nga regjistri i profesionit të përmbauesit privat , te Te shtohet “ apo i kufizohet zotesia per te vepruar”.
27. Konstatojme se ne piken “f” te nenit 25 duhet te ketë një dallim, sepse nese pezullimi eshte bere nga Min.Drejtësisë, eshte ky i fundit qe duhet t’ja lejoje rifillimin e punes kur heq pezullimin. Pra ne kete rast pezullimi, nuk kemi te bejme me rifillim. Ndryshe qendron kur vete permbauese e ka kerkuar pezullimin.
28. Në nenin 25 shkronja ”d” të projektligjit, të titulluar ”Çregjistrimi nga regjistri i profesionit të përmbauesit privat”, parashikohet se përmbauesit privatë të organizuar si persona juridikë tregtarë çregjistrohen nga regjistri profesional në rast se kalojnë në procedurë likuidimi. Meqenëse nenet 43, 47, 99, dhe 187 të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” parashikojnë se likuidimi është vetëm një nga shkaqet e ligjshme të prishjes së shoqërive tregtare, sugjerojmë që shkronja “d” e nenit 25 të projektligjit të riformulohet si vijon:
- Cit:”Për çdo shkak të ligjshëm të prishjes së shoqërive tregtare, në rast se është një person juridik”*
29. Në fjalinë e dytë të nenit 27 të projektligjit parashikohet se Dhoma Kombëtare e Përmbauesëve është person juridik privat por nuk specifikohet forma juridike e organizimit të saj si person juridik privat. Për këtë arsye sugjerojmë që, në përputhje me nenin 26 të Kodit Civil, neni 27 të plotësohet duke përcaktuar konkretisht formën e organizimit juridik të Dhomës Kombëtare të Përmbauesëve si shoqëri, shoqatë, fondacion etj...
30. Ne piken “e” te nenit nr 29 mendoj se duhet Te ndryshohet “.. ne raport me Min.Drejtësisë, organiet e tjera te administrates shteterore, organizmat nderkombetare dhe palet e treta.
31. Në shkronjën “e” të nenit 36 parashikohet e drejta e përmbauesit privat për të vendosur gjoba ndaj subjekteve që pengojnë ekzekutimin. Parashikohet që gjobat vendosen në zbatim të KPC, por konstatojmë se në KPC nuk ekziston një përcaktim me natyrë kaq të përgjithshme, përveçse nenit 588 të KPC. Gjithashtu shprehim mendimin se përmbauesit privat, në ushtrimin e veprimtarisë së tyre, edhe pse kryejnë një shërbim publik, nuk mund të vendosin gjoba (sanksione administrative) të cilat normalisht vendosen nga organet shtetërore, të cilat si rrjedhim kanë edhe detyrimin e vjeljes (arkëtimit) të tyre. Gjoba, është një institut i të drejtës publike dhe si rrjedhim është prerogativ e organeve të administratës publike në ato raste kur ato autorizohen shprehimisht me ligj. Mendojmë se përmbauesit privat nuk mund t’u jepet një kompetencë e tillë, e cila bie ndesh me parimet e së drejtës.
32. Per nenin 36, te drejtat e permbauesit privat per pikat b, c, d dhe e – keto jane ne K.Pr.Civile qe permbauesi privat detyrohet ta zbatoje/ apo edhe te tretet ne raport me permbauesin privat.
33. Ne piken “f” te nenit 37, detyra e permbauesit privat Te ndryshoje “pervec kur dhenia e ketij informacioni eshte detyim ligjor”.
34. Ne nenin 38 , pika “b” mendoj se duhet Te shtohet “apo presion psikologjik.....”

35. Konstatohet se në nenin 40, konfidencialiteti, pika “c”, fillimisht duhet shtuar palet në proces, pastaj të tjerat.

36. Në nenin 43, Te shtohet “ dhe dokumentacionin e përcaktuar nga K.Pr.Civile. Referuar praktikës së deritanishme të funksionimit të shërbimit përbarimor shtetëror, sipas të cilës përbaruesit shtetërorë refuzojnë ekzekutimin e titujve ekzekutivë edhe në rastet kur pala kreditore e ka objektivisht të pamundur të sigurojë informacion për gjendjen pasurore të palës debitore, jemi të mendimit se mënyra e formulimit të dispozitës së sipërcituar të projektligjit mund të krijojë premisat që edhe përbaruesit privatë të refuzojnë ekzekutimin e titujve ekzekutivë kur pala kreditore nuk mund të sigurojë informacion për gjendjen pasurore të debitorit. Për këtë arsye, si dhe në funksion të krijimit të një shërbimi përbarimor privat sa më efikas, sugjerojmë që fjalia e dytë e nenit 43 të projektligjit të riformulohet si vijon:

*Cit: “Pala kreditore informon përbaruesin privat për gjendjen pasurore të palës debitore, por mosinformimi ose pamundësia për informim nuk mund të përbëjë shkak të ligjshëm që përbaruesi privat të refuzojë kryerjen e veprimeve procedurale përbarimore dhe/ose ekzekutimin e titullit ekzekutiv.”*

37. Në fjalinë e parë të nenit 43 të projektligjit, të titulluar “Marrëdhëniet me palën kreditore”, përcaktohet shprehimisht se:

*Cit:” Marrëdhëniet ndërmjet përbaruesit privat dhe palës kreditore rregullohen mbi bazën e kontratës së lidhur mes tyre”*

Jemi të mendimit se ky përcaktim ligjor është i pamjaftueshëm sepse përpara se të cilësohen si marrëdhënie kontraktore, marrëdhëniet ndërmjet përbaruesit privat dhe palës kreditore janë marrëdhënie ndërmjet subjekteve procedurale në procedurën e ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutivë, dhe si të tilla rregullohen në radhë të parë mbi bazën e dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurës Civile, të këtij ligji dhe të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore të zbatueshme. Rregullimi kontraktor i këtyre marrëdhënieve mund të aplikohet në mënyrë lejuese, vetëm në rastet kur nuk parashikohet ndryshe në dispozitat urdhëruese përkatëse të Kodit të Procedurës Civile, të këtij ligji dhe të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore të zbatueshme. Bazuar në argumentat e mësipërme sugjerojmë që fjalia e parë e nenit 43 të projektligjit të riformulohet si vijon:

*Cit:” Marrëdhëniet ndërmjet përbaruesit privat dhe palës kreditore rregullohen mbi bazën e këtij ligji, të Kodit të Procedurës Civile, të akteve të tjera ligjore e nënligjore të zbatueshme, si dhe të kontratës së lidhur mes tyre”.*

38. Në fjalinë e dytë të nenit 43 të projektligjit, të titulluar “Marrëdhëniet me palën kreditore”, përcaktohet shprehimisht se:

*Cit: “Pala kreditore informon përbaruesin privat për gjendjen pasurore të palës debitore.”*

Referuar praktikës së deritanishme të funksionimit të shërbimit përbarimor shtetëror, sipas të cilës përbaruesit shtetërorë refuzojnë ekzekutimin e titujve ekzekutivë edhe në rastet kur pala kreditore e ka objektivisht të pamundur të sigurojë informacion për gjendjen pasurore të palës debitore, jemi të mendimit se mënyra e

formulimit të dispozitës së sipërcituar të projektligjit mund të krijojë premisat që edhe përmbaruesit privatë të refuzojnë ekzekutimin e titujve ekzekutivë kur pala kreditore nuk mund të sigurojë informacion për gjendjen pasurore të debitorit. Për këtë arsye, si dhe në funksion të krijimit të një shërbimi përmbarimor privat sa më efikas, sugjerojmë që fjalia e dytë e nenit 43 të projektligjit të riformulohet si vijon:

*Cit: “Pala kreditore informon përmbaruesin privat për gjendjen pasurore të palës debitore, por mosinformimi ose pamundësia për informim nuk mund të përbëjë shkak të ligjshëm që përmbaruesi privat të refuzojë kryerjen e veprimeve procedurale përmbarimore dhe/ose ekzekutimin e titullit ekzekutiv.”*

39. Neni 44, nuk është e qartë se kush e vendos këtë rast, kështu siç është shprehur le shteg për abuzim në dem të kreditorit. Dhe mendoj se ka nevojë për rishikim i gjithë neni, veçanërisht për anën financiare të prishjes së kontratës me tyre.
40. Në Kreun V, kuptojmë se parashikohen organet, kompetencat dhe funksionet e Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Privat. Kuptojmë se Dhoma përbëhet nga 2 (dy) organe: Mbledhja e Përgjithshme dhe Këshilli i Përgjithshëm. Konstatojmë se në përmbajtjen e dispozitave të këtij kreu ka disa paqartësi, të cilat i listojmë si më poshtë:
- a) Bëhet konfuzion në përdorimin e termave: “mbledhje e përgjithshme” dhe “asamble e jashtëzakonshme” (neni 33, neni 35, shkronja “h”);
  - b) Kush është shumica e nevojshme (quorumi) për zhvillimin e mbledhjes së parë të Mbledhjes së Përgjithshme dhe mbledhjeve vijuese?
  - c) Vendimmarrja parashikohet me shumicë të thjeshtë votash?
  - d) Kush e zgjedh drejtuesin e Dhomës? Po Mbledhja nga kush drejtohet? Po Këshilli i Përgjithshëm ka drejtues? Kush e thërret mbledhjen e Këshillit?
41. Në neni 46, heqja dore nga procedura e ekzekutimit, mendoj se duhet të shtohet “për mosdemtimin e interesave të palës kreditore” dhe se kjo shprehje është abuzive. Parapagimi për ekzekutimin duhet t’i kthehet kreditorit detyrimisht.
42. Në paragrafin e dytë të nenit 47, mendojmë se fjalia e dytë, nëpërmjet parashikimit që bën, bie ndesh me parimet e KPC, sepse përmbaruesi gjyqësor, mund të thirret në çdo moment në gjykim, por debitori është ai që me padinë përkatëse vë në lëvizje gjykatën në lidhje me pretendimet që ngre. Pra, mendojmë se përmbaruesi gjyqësor privat nuk mund të thirret në gjykim në cilësinë e debitorit.
43. Në neni 47, Marrëdhëniet me palën debitore dhe personin e tretë, të shtohet “ dhe personat e barazuar me të” – këtu kemi parasysh dorëzanësin, hipotekuesin, dhe se pjesa “...mbi sendet e luajtshme e të paluajtshme të tij” duhet hequr sepse le shkak për keqkuptim. Mund të preken edhe të drejtat kreditore që një debitor mund të ketë tek një palë e tretë. Pra ideja të jete vetëm ato që lejon K.Pr.Civile
44. Konstatojmë se në neni 49, marrëdhënie me të tretet, të shtohet ‘Sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile’. Në variantin që jep drafti mund të bëhet shkak për kërkime abuzive të përmbaruesve veçanërisht ndaj bankave që janë mbajtëse të llogarive bankare të subjekteve të ndryshme. Po kështu duhet të respektoje edhe procedurat që vendosen me akt nënligjor nga BSH (kusht i nenit 600 të K.Pr.Civile)



45. Neni 49 rregullon marrëdhëniet e përmbaruesve privat me institucionet e administratës publike dhe me subjekte private, duke vendosur detyrimin për këta të fundit të japin çdo të dhënë pasurore të debitorit pas paraqitjes së kërkesës përkatëse të përmbaruesit. Në lidhje me këtë parashikim, mendojmë se duhet të merret në konsideratë fakti se shumë institucione, të cilat rregullohen me ligje të veçanta, e kufizojnë dhënien e informacioneve palëve të treta. Gjithashtu, shumë institucione, por edhe subjekte private, në bazë të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale kanë detyrimin të mbrojnë të dhënat konfidenciale. Në paragrafin e dytë të nenit 49 përcaktohet shprehimisht citojmë: *“në raste të veçanta, përmbaruesi privat ka të drejtë që të kërkojë asistencën e institucioneve shtetërore apo subjekteve private, për të mundësuar procedurat e ekzekutimit”*. Shprehim mendimin se ky parashikim është shumë subjektiv, sepse së pari lë vend për shumë interpretim në lidhje me “veçantinë” e rasteve të ekzekutimit dhe së dyti për interpretimin e asistencës që mund të kërkohet.
46. Në paragrafin e dytë të nenit 50 parashikohet që përmbaruesit privat, të mos paguajnë taksën përmbarimore, në derogim të ligjit për taksat, ndërsa paragrafi i tretë parashikon që ata të paguajnë një tarifë. Shprehim mendimin se dispozitat e mësipërme janë konfuzë, sepse sipas ligjit për taksat, aktualisht, taksa përmbarimore paguhet nga kreditori i cili kërkon ekzekutimin e titullit dhe jo nga përmbaruesi. Për këtë arsye, mendojmë se paragrafi i dytë nuk mund të jetë përjashtim nga ligji për taksat, për sa kohë që bëhet fjalë për dy gjëra të ndryshme. Për sa i përket tarifës, mendojmë se duhet të përcaktohet organi të cilit i paguhet kjo tarifë.
47. Te neni 50, përcaktimi tarifave, shprehim mendimin se dispozitat e mësipërme janë konfuzë, sepse sipas ligjit për taksat, aktualisht, taksa përmbarimore paguhet nga kreditori i cili kërkon ekzekutimin e titullit dhe jo nga përmbaruesi. Për këtë arsye, mendojmë se paragrafi i dytë nuk mund të jetë përjashtim nga ligji për taksat, për sa kohë që bëhet fjalë për dy gjëra të ndryshme. Për sa i përket tarifës, mendojmë se duhet të përcaktohet organi të cilit i paguhet kjo tarifë. Dhe se dy paragrafët e fundit janë te paqarta, duhen ripunuar si dhe saktësuar për çfarë rasti do aplikohet mospagimi i taksës përmbarimore, po kështu edhe rasti i dhënë në paragrafin e fundit.
48. Te neni 51, tarifa shtese, pjesa “...ka te drejte te kerkoje pagimin e nje tarife shtese” mendoj se Kjo i hap rruge abuzivitetit qe përmbaruesi privat vetëm te kërkoje nga kreditori (cdo behet me këto pagesa extra kur përmbaruesi ta ktheje pa veprim apo me një përfitim minimal financiar tek kreditori?). Mendojmë se duhet rishqyrtuar patjetër
49. Mendoj se Neni 52, rastet e pakethyeshmerise se tarifës, duhet ripare, aq me tepër qe përmbaruesi sipas këtij ligji ka te drejtën “te zgjedhe” dosjet qe ai i gjykon te vlefshme.
50. Në lidhje me nenet 53 dhe 54 që parashikojnë procedimin disiplinor, mendojmë se duhet të qartësohet se e kujt është kompetenca e nisjes së procedimit disiplinor: e Ministrit të Drejtësisë apo e Komisionit Disiplinor. Gjithashtu konstatojmë se Ministri i Drejtësisë ka kompetencën që të vendosë për pezullimin e liçencës në rastin kur është bërë një shkelje disiplinore, por vërejmë se nuk parashikohet mënyra se si përmbaruesi do rifillojë aktivitetin e tij pas rënies së kësaj mase disiplinore.